

## Nxitja e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së pakicave në Evropën Juglindore



Projekti i përbashkët i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, “Nxitja e të drejtave të njeriut dhe mbrojtja e pakicave në Evropën Juglindore” ka si objektiv të përgjithshëm **përmirësimin e aksesit të pakicave në të drejtat e tyre** në nivele të ndryshme të qeverisjes në Evropën Juglindore, bazuar në standardet e Këshillit të Evropës në këtë fushë dhe veçanërisht në **Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (KKMPK)** dhe **Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave (KEGjRP)**.

Tri objektiva specifike do të kontribuojnë më nënryre plotësuese për të arritur objektivin e përgjithshëm:

- 1) Mbështetja e pushtetit lokal për forcimin e politikave dhe kapaciteteve me qëllim zbatimin në praktikë të rekomandimeve mbi respektimin e të drejtave të pakicave, në njësitë e pushtetit vendor të përzgjedhura në rajon;
- 2) Identifikimi dhe shkëmbimi i praktikave të mira midis njërive vendore pjesëmarrëse dhe krijimi i modeleve që mund të përshtaten për t’u përdorur në njësitë e tjera të rajonit;
- 3) Ofrimi i mbështetjes për ndryshime legjislative dhe të politikave në nivelin e qeverisjes qendrore, mbështetur në të dhënat në nivel lokal, së bashku me rekomandimet nga raportet e monitorimit të KiE-së.

Në kuadër të objektivit të parë, synimi është të mbështeten njësitë e pushtetit vendor të përzgjedhura për hartimin e reagimeve konkrete për kalimin e pengesave për zbatimin e të drejtave të pakicave në nivel lokal, me mbështetjen e granteve tematike, shoqëruar me ekspertizën sistematike lokale dhe ndërkombëtare të KiE-s në terren. Tridhjetegjashtë njësi vendore do të përzgjidhen nëpërmjet një procedure të hapur, bazuar në kriteret e parapërcaktuara në fushën e arsimit, medias, përdorimit zyrtar të gjuhëve dhe shkrimeve, kulturës, mosdiskriminimit, dhe pjesëmarrjes efikase të personave që u përkasin pakicave kombëtare në jetën kulturore, sociale dhe ekonomike dhe në punët publike.

Në emër të Komitetit Drejtues të projektit, sekretariati i Projektit shpall:

### Thirrjen për shprehje interesi

Thirrja është e hapur për të gjitha bashkitë e Evropës Juglindore (Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë, Kroaci, Mali i zi, Serbi, Ish-republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Kosovë<sup>1</sup>), ku jetojnë minoritete.

<sup>1</sup> Ky përcaktim nuk paragjykon qëndrimet mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KSKB-së dhe opinionin e GjND-së mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

Grantet e projektit të KiE-s janë të kufizuara në vlerën 18.000,00 euro për çdo njësi vendore të përzgjedhur. Njësitë e përzgjedhura do të kontribuojnë me 10% të buxhetit të përgjithshëm të projektit, vlerë e cila nuk duhet t'i kalojë 20.000 euro.

Afati përfundimtar për dorëzimin e aplikimeve është **data 15 shtator 2014 (ora 24:00)**.

Aplikimet do të vlerësohen nga komisionet lokale të vlerësimit, bazuar mbi kritere të shpallura publikisht. Aplikuesit e përzgjedhur do të përfitojnë ndihmë për hartimin e projekteve, sipas nevojës.

Grantet do të shpërndahen në fillim të muajit dhjetor të vitit 2014.

Një informacion më të gjerë mbi procedurën e dhënies së grantit, kriteret dhe formularin e aplikimit do ta gjeni në [Kriteret për përzgjedhjen e njërive të pushtetit vendor](#) në [Udhëzuesin për aplikimin](#) si edhe në [Formularin e Aplikimit](#), të cilët mund të shikohen dhe shkarkohen në: <http://pjp-eu.coe.int/web/minority-rights>.